

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“FUTURA-OFFICE ” SH.P.K**

Në zbatim të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe ligjit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise ,themeluesit:

1- Z.Michael Schmidt lindur me 01.05.1959,dhe banor ne Gjermani,ne Frankfurt am Main Eckenheimer Landstr,60°,shtetas Gjerman,identifikuar me ID nr C5HT91FC3 madhor e me zotesi te plotë Juridike per te vepruar.

2- Z. Gentian Ndregjoni lindur më dt 26.01.1986ne Selishte,Diber, banor në Tiranë, Njesia bashkiake nr.11, Rruga Azem Galica, Ndertesa private nr.1, shtetas Shqiptar ,identifikuar me karte identiteti nr.I60126014W madhere e me zotësi të plotë Juridike për të vepruar.

Vendosen sote date 08.02.2021 per themelimin e kompanise **“FUTURA-OFFICE ” SH.P.K.**

**KREU I**

**Emërtimi-Forma ligjore- Objekti  
Selia- Afati-Vula**

**Neni 1**

Shoqëria do te mbaj emerin **“FUTURA-OFFICE” Shpk**,dhe emer tregetar **“FUTURA-OFFICE” Sh.p.k**,me ortakë Z. Michael Schmidt dhe Gentian Ndregjoni .

Emërtimi i shoqërisë do të shfaqet në të gjitha aktet që do të dalin në emër dhe për llogari të shoqërisë.

**Neni 2 – Forma ligjore**

Kompania eshte një Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar,ne baze te ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” shoqeria mund te konvertohet ne një forme tjeter me vendim te themeluesve te saj.

**Neni 3 - Objekti**

**Shoqëria ka si objekt të aktivitetit tësaj :**



Tregetim me shumice dhe pakice te mobiljeve, elementeve te drurit, import, eksport etj. Transport per te trete. Riparim mobiljesh, lyerje mobiljesh, dhenie mobilje me qera. Eksport – Import te cdo makinerie apo pajisje qe ka lidhje me prodhimin, si dhe cdo materiali tjeter te nevojshem qe lidhet me aktivitetet e larte permendura. Shfrytezim, Prodhim, Perpunim, Tregtim dhe Transport i lendes drusore, te paperpunuar dhe te perpunuar, si pishe, ah, lis etj si dhe druve te zjarrit. Tregtim prodhimesh te ndryshme druri, mobilie, orendi etj. Te merret me promovimin e shkembimeve tregtare nga Shqiperia per jashte dhe nga jashte per ne Shqiperi. Prodhimin dhe tregetimin e produkteve, me baze materiale te ndryshme, per te gjithe sektore e ekonomise. Prodhim dhe tregtim me shumice e pakice te artikujve tregtare, konfeksione, tekstil per llogari te vet dhe per te trete. Tregtim artikujsh te ndryshem, import-eksport. Tregtim paisjesh elektro-shtepiake, elektrike, higjenosanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati etj. Tregtim materialesh ndertimi e lendesh te para, import- eksport. Marrja pjese ne tendera dhe ankande si dhe kryerja e sherbimeve qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj. Tregtim i materialeve te ndryshme me shumice dhe pakice ne format e parashikuara dhe te lejuara nga legjislacioni shqiptar. Tregetim me shumice e pakice, prodhimin, importi dhe eksporti i te gjitha llojeve te mallrave te lejuara nga Ligji, brenda dhe jashte vendit, per llogari te vete shoqerise si dhe te te treteve. Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufijve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, mund te kryeje cdo operacion prodhimi, tregtar dhe finanziar, qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura sa me siper. Te marre apo jape me qera, kontrakte, te drejten e markes, patentes, licences, dhe te drejtat e tjera qe jane te ngjashme me keto. Import - Eksport, tregtim detergjent, dezifikant, aromatizues si dhe material pastrimi.-Cdo aktivitet tjeter qe lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e lartepermendura dhe qe nuk ndalojen me ligj ne territorin e Republikës se Shqipërise.

#### Neni 4 - Selia

Selia ligjore e Shoqërisë është nëTiranë ,Njesia bashkiake nr.11, Rruga Azem Galica, Ndertesa private nr.1.

Asambleja e shoqërisë ka të drejtë të hap seli të tjera dytësore, filiale, zyra përfaqësimi dhe seli prodhimi si në Shipëri ashtu edhe jashtë saj, madje të trasferojë Selinë e Shoqërisë, por kjo e fundit do të mbetet gjithësesi në territorin e Republikës se Shqipërisë.

#### Neni 5 - Kohëzgjatja e veprimtarisë

Aktiviteti i Shoqerise do te filloj ne daten e regjistrimit te tij ne QKB. Kohëzgjatja e veprimtarisë së kesaj Shoqërije është me afat te papërcaktuar,por shoqëria mund të shpërbëhet në çdo moment me vendim të Asamblesë se Ortakëve.

## **Neni 6-Vula**

Shoqeria do te kete vulen e saj me te drejte perdonimi nga administartori i saj. Forma e vules dhe madhesia e saj do te percaktohen nga ortaket themelues ne perputhje me kerkesat perkatese ligjore ne Shqiperi.

## **KREU II KAPITELI THEMELTAR DHE KUOTAT**

### **Neni 7 -Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1.500.000 (një miljon e peseqind mijë) lek dhe mund të rritet në bazë të modaliteteve ligjore.

### **Neni 8 – Vlera e kuotave dhe pjesëmarrja**

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, të mbajtuara nga ortakët e Shoqërisë në këtë mënyrë:

Z. Michael Schmidt mbajtës i 1 (një) kuote, baraz me 80% të kapitalit me vlerë nominale prej 1.200.000 lek

Z. Gentian Ndregjoni mbajtës i 1 (një) kuote, baraz me 20% të kapitalit me vlerë nominale prej 300,000 lek

### **Neni 9 – Trasferimi i kuotave**

Kuotat e kapitalit janë lirisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve. Trasferimi i kuotave ndaj të tretëve- jo ortakë, do t'i nënshistrohet respektimit të së drejtës së parablerjes. E drejta e parablerjes i përket cdo ortaku, në proporcione kuotat e mbajtura dhe duhet të ushtrohet Brenda 30 ditëve kalendarike nga oferta e njofuar nga oratku që ka vullnetin për shitjen e kuotave. Oferta duhet të njoffohet me postë të regjistruar dhe marrja e njofimit duhet të jetë konfirmuar.

Në rast mosekzekutimi të sëdrejtës së parablerjes brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e njofimit për ofertën e shtjes, kuotat mund t'i trasferohen palëve të treta.

### **Neni 10 – Zvogelimi apo rritja e kapitalit**

Ortaket mund te rrisin ose zvogelojne kontributet e tyre ne kapitalin themeltar vetem me vendim te ortakeve te saj, ne masen e lejuar nga ligji, perndryshe kompania duhet te ndryshoj formen e vet ligjore.



## **Neni 11 – Financimet**

Financimet e bëra nga ortakët, në proporcion me kuotat e mbajtura dhe në përputhje me vendimet e asamblesë, janë të lira nga interesat.

### **KREU III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORI DHE EKSPERTI KONTABEL**

## **Neni 12 – Asambleja e Ortakëve dhe kompetencat e saj**

12.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

12.2 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50 (pesëdhjetë) % të të gjithë kapitalit themeltar dhe asambleja do të vendlloj me votën e ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit themeltar.


12.3 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë për të cilat kërkohet një shumicëe kualifikuar, janë të vlefshme nëse, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytë janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnëtë paktën  $\frac{3}{4}$  e të gjithë kapitalit themeltar dhe Asambleja do të vendlloj si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytë me votën e ortakëve që përfaqësojnë  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar.

Jane competence vetem e asamblese se shoqerise detyrat si vijone:

- Percaktimi i palistikave tregetare te shoqerise
- Te ndryshoj nenet e ketij statusi
- Emerimin apo shkarkimin e administratorit
- Emerimin apo shkarkimin e auditoreve
- Percaktimin e pages apo shperbilimeve te administratorit dhe audituesit
- Te ndryshoj selin e shoqerise
- Te ndryshoj emrin e shoqerise
- Rritje ose zvogelimin e kapitalit te soqerise
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- Miratimin e rregullores se punes per mbarvajtjen e shoqerise
- Ceshtje te tjera qe kerkohen me ligj ose status

## **Neni 13 – E drejta e pjesëmarrjes së votës**

13.1 Cdo ortak katë drejtë të marr pjesë në Asamble dhe të paraqes mendimin e tij dhe të jap po aq vota sa është numri i kuotave të kapitalit që ai zotëron.



13.2 Cdo ortak katëdrejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës do të japë votën e tij.

13.3 Ortaku nuk mund të lëshoj prokurë për votim për një pjesë të kuotave të kapitalit që ai zoteron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur të kuotave.

#### **Neni 14 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve**

14.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, Brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar, me qëllim miratimin e Bilancit, të Raportit të Administratorit, Ekspetit Kontabël si dhe Inventarit.

14.2 Asambleja mund të thirret në cdo moment nga një prej administratorëve ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se 5 (pesë) % të kapitalit themeltar.

14.3 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve dhe Ekspertit Kontabël, nëse është emëruar një i tillë, të paktën 7 (shtatë) dite kalendarike përparrë mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përbaj informacion mbi llojin e Asamblesë, si dhe çështjejt që do të trajtohen dhe përfundimet e cilat do të duhet të merret vendim, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

14.4 Asambleja mund të thirret dhe jashtë Selisë së Shoqërisë, në Shqipëri dhe jashtë saj.

14.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes. Asambleja konsiderohet në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.

14.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht dhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar.

14.7 Cdo Asamble do të drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga e njëjtë Asamble. Për pasqyrimin e vendimit, Asambleja emëron një sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

14.8 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë.

#### **Neni 15 – Administrimi**

15.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i cili qëndron në detyrë deri në revokim apo dorëheqje, përfundimisht maksimale prej 5 (pesë) vjetësh, me te drejten e rinovimit.

15.2 Përfaqësimi ligjor do ti besohet administratorit Z. Gentian Ndregjonji.



Administratori do të ushtroj të gjitha kompetencat sipas parashikimeve të nenit 95 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 " Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

15.3 Administratori mund të emëroj përfaqësues të posaçëm për akte të vecanta ose kategori aktesh.

### **Neni 16 – Eksperti Kontabel I Autorizuar**

16.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakëve, kontrolli i Pasqyrave Financiare dhe Librave Kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të licensuar.

16.2 Eksperti Kontabel i licensuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

### **KREU IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 17**

17.1 Viti Financiar fillon me datë 1 Janar dhe mbaron në datë 31 Dhjetor të secilit vit kalendarik.

17.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

17.3 Bilancet vjetore, Raportet e administratorit dhe ekspertit kontabel të autorizuar, nëseështë emëruar, miratohen nga Asambleja e Ortakëve me shumicën e përcaktuar sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 " PërTregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

17.4 Miratimi i dokumenteve që lidhen me Vitin Financiar duhet të bëhet Brenda 6 (gjashtë) muajve nga fundi i Vtit Financiar.

#### **Neni 18 – Fitimet**

18.1 Fitimet që rezultojnë nga Bilanci vjetor, duke zbritur 5 (pesë) % të destinuara për rezervën ligjore deri në 10 (dhjetë)% të kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos të lër mënjanë, u shpërndahen oratkëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara,pasi eshte paguar dividenti.



18.2 Asambleja mund të vendos dhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

## **KREU V SHPERNDARJA DHE LIKUDIMI I SHOQERISE**

### **Neni 19 – Prishja**

19.1 Shoqëria prishet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në Statut.

19.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes ose falimentit të njërit ose disa ortakëve.

### **Neni 20 – Likujdimi**

20.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likujdohet.

20.2 Për të administruar këtë proces, Asambleja emëron një ose më shumë Likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare, mbi gjendjen e Aktiveve dhe Pasiveve të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për përfundimin e likuidimit.

20.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendos mbi Bilancin Financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga Likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

20.4 Pas pagimit të kreditoreve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do të shpërndaj të ardhurat përfundimtare të likuidimit oratkëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara prej tyre.

### **Neni 21 – Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

21.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti, si dhe ato që mund të lindin në perjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale dhe jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve të Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

21.2 Në rast se nuk arrihet një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do ti besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Neni 22 – Gjuha**

22.1 Ky Statut është përbërë nga 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore

Lexuar, gjetur konform vullnetit të lirë e të pavarur, pranuar dhe nënshkruar nga ortakët themelues.

### **ORTAKET THEMELUES**

**Michael Schmidt**

**Gentian Ndregjoni**

The image shows two handwritten signatures. The top signature is for Michael Schmidt, featuring stylized letters 'M' and 'S'. The bottom signature is for Gentian Ndregjoni, featuring a more fluid and cursive style.